Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helpthelife.org.al
W: www.helpthelife.org

# TERMA REFERENCE (ToR)
# Pozicioni: Shofer

**Qendra Sociale Multifunksionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara**
**Organizata:** Shoqata "Ndihmoni Jetën"
**Vendndodhja:** Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë
**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 muaj (me mundësi rinovimi)
**Forma e punësimit:** Me kohë të plotë

## 1. Hyrje – Qëllimi i qendrës

Qendra Sociale Multifunksionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata "Ndihmoni Jetën", ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

.

## 2. Përshkrimi i rolit

Shoferi është përgjegjës për transportin e personelit, përfituesve të shërbimeve dhe materialeve të Qendrës Sociale Multifunksionale në mënyrë të sigurt dhe të efikase, duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor dhe udhëzimet drejtuesve të qendrës.

## 3. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Kryejë transportin e personelit, përdoruesve dhe materialeve të qendrës në mënyrë të sigurt dhe efikase, sipas itinerareve të përcaktuara.
- Sigurojë mirëmbajtjen bazë të automjeteve, duke përfshirë pastrimin, kontrollin e karburantit, vajit dhe gjendjen teknike.
- Respektojë rregullat e qarkullimit rrugor dhe procedurat e brendshme të qendrës.
- Mbajë dokumentacionin e udhëtimeve dhe raportet e automjeteve sipas kërkesave të menaxhmentit.
- Bashkëpunojë me stafin e qendrës për planifikimin e itinerareve dhe për të përmbushur nevojat operative të transportit.

## 4. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

Punonjësi/ja do të:

- Patentë shoferi e vlefshme për kategorinë e automjetit që do të përdoret kategoria C.
- Përvojë e dëshmuar në drejtimin e automjeteve dhe transportin e personave/materialeve.
- Njohuri bazë mbi mirëmbajtjen e automjeteve.
- Aftësi bazë për menaxhimin e kohës dhe planifikimin e itinerareve.

Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helpthelife.org.al
W: www.helpthelife.org

**5. Procedura e aplikimit**

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026, ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Fotokopje e kategorise të patentes qe zoteron;
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
-

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helpthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e deshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.